



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Ac.nr.999/17**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Gani Avdiu e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit T.P. nga Ferizaj, tani me vendqendrim në ... – Republika e Serbisë rr.”..., të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij Z.GJ. nga fshati ..., komuna e Shtërpçës, kundër të paditurit SH.H. nga fshati ..., komuna e Ferizajit, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.J.R. nga Ferizaj, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.593/07, të datës 24.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.11.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit T.P. nga Ferizaj, tani me vendqendrim në ... – Republika e Serbisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.593/07, i datës 24.10.2016, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që t’ia kompensoj atij shumën prej 4.458 euro, në emër të borxhit për shitblerjen e tre qeve (bikave). Po ashtu është obliguar paditësi që të paditurit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë për një përfaqësim të avokatit shumën prej 270 euro, për taksën gjyqësore për padi 25 euro, si dhe për aktgjykim 25 euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të pasojave ligjore.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vëretimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin ashtu që ta aprovojë

kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të bazuar apo që aktgjykimin në fjalë ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

I padituri përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ankesën e paditësit ta refuzoj si të pabazuar, kurse aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, ta vëretoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditësit, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 19.12.2007, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit për shkak të borxhit, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se pas vlerësimit të provave është provuar se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit në raport me të paditurin është refuzuar për shkak të parashkrimit, pasi që në bazë të shkresave të lëndës provohet se shitblerja e pretenduar e qeve (bikave) ka ndodhur në vjeshtën e vitit 1998, kurse paditësi padinë e ka parashtruar në gjykatë në fund të vitit 2007, për çka duke u bazuar në nenet 352 dhe 341 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Mardhëniet e Detyrimeve (LMD), ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në raport me shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenet 452.1 dhe 449.1 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, në ndërkohë që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kjartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të tij, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qendrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Gjykata e shkallës së parë kërkespadinë e paditësit e ka refuzuar për shkak të parashkrimit të saj, me të cilin përfundim pajtohet në plotëni edhe gjykata e shkallës së dytë. Andaj pretendimet e paditësit mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qendrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pathemelësinë kërkesëpadisë së paditësit, është i drejtë dhe i argumentuar. Me nenin 371 të LMD të zbatueshëm për këtë rast (1978) parashihet se “*Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit*”. Duke qenë se paditësi padinë e tij kundër të paditurit për pagesën e borxhit të pretenduar, e ka parashtruar më 19.12.2007, në ndërkohë që raporti civilo juridik – detyrimor supozhet se është krijuar në vitin 1998, atëherë i bie që vëretë padia e tij në këtë rast, është e parashkruar për shkak se ka kaluar afati 5 vjeçar i paraparë me nenin 371 të LMD së vitit 1978, i cili zbatohet për këtë rast. Zbatimi i këtyre dispozitave të lartcituara në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit, në rastin konkret është e pabazuar.

Përndryshe, gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, përkatësisht është bazuar në dispozitat e LMD të ri të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2012, edhe pse i njëjti ligj nuk ka efekt prapaveprues për marrdhëniet juridiko detyrimore të cilat janë krijuar para se ai të filloj së zbatuari. Megjithatë, ky zbatim i gabuar i ligjit material të përmendur, nuk ka pasur ndonjë efekt për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore, por për hir të praktikës gjyqësore, gjykata e shkallës së dytë e pa të arsyeshme që të konstatoj këtë lëshim të gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu, gjykata e shkallës së dytë përmes aktit përcjellës të datës 26.02.2020, lëndën e ka kthyer tek gjykata e shkallës së parë, për ta sqaruar faktin se dorëzimit të aktgjykimit palës paditëse, përkatësisht të autorizuarit të tij, pasi që në shklresat e lëndës kanë munguar provat për provimin e këtij fakti. Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas kërkesës së gjykatës së shkallës së dytë, përmes aktit të saj përcjellës të datës 16.10.2020, e ka informuar këtë të fundit, se përkundër përpjekjeve të bërë nuk ka rritur që ta siguroj provën – fletëkthesën apo fletëdërgesën, përmes të cilës do të provohej afatshmëria e ankës së paditësit në këtë rast. Megjithatë, duke i marrë për bazë rrethanat e rastit dhe për hir të respektimit të të drejtave procedurale të palëve, gjykata e shkallës së dytë, ankesën në fjalë të paditësit e ka konsideruar si të afatshme, por për arsye të cekura si më lartë, të njëjtën e ka refuzuar si të pabazuar.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paditësit, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë të pabazuara, të paargumentuara dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK, u vendos si më lartë.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.999/17, me datën 16.11.2020**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**